



**LOTARIA KOMBËTARE**

**Lotaria Kombëtare sh.p.k.**

**Pasqyrat financiare  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

## Përmbajtja

### Raporti i Audituesve të Pavarur

#### Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019:

Pasqyra e pozicionit financiar.....	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.....	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital .....	3
Pasqyra e flukseve monetare .....	4
Shënime për pasqyrat financiare .....	5 – 31



# Raporti i Audituesit të Pavarur

---

Për Drejtimin dhe Aksionarin e Shoqërisë Lotaria Kombëtare Sh.a.,

## Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë Lotaria Kombëtare Sh.p.k. (më poshtë “Shoqëria”) që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2019, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, dhe një përmbledhje të politikave kontabël dhe informacione të tjera sqaruese, të përfshira nga faqja 5 deri në faqen 31.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Lotaria Kombëtare Sh.p.k. paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2019, performancën e saj financiare dhe flukset e monetare për vitin e mbyllur dhe ndryshimet në kapital në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

## Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit Ndërkombëtar për Standardet e Etikës për Kontabilistët (Kodi i IESBA) dhe Kodit të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (Kodi i IEKA), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 Mars 2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të amenduar, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

TPA Albania shpk

Rr.Reshit Collaku, Pall.Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Albania

[www.tpa-group.com](http://www.tpa-group.com)

## **Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen Për Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, për shënimet shpjeguese për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveç sa më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### **Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme të rëndësishme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.

**TPA Albania shpk**


Rr.Reshit Collaku, Pall.Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Albania

[www.tpa-group.com](http://www.tpa-group.com)

- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë, e parimit të vijëmsisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijëmsi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijëmsi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Date 19 Qershor 2020



Ilir Binaj, CPA, CGMA, Auditor Ligjor



**Lotaria Kombëtare sh.p.k**  
**Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019**  
*(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<b>Aktive</b>			
Aktive afatgjata të trupëzuara	6	123,621,586	132,196,304
Aktive me të drejtë përdoimi	7	16,831,257	-
Aktive afatgjata të patrupëzuara	8	203,519,783	219,709,851
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>343,972,626</b>	<b>351,906,155</b>
<b>Tatim fitimi i parapaguar</b>			
		40,000	40,000
Inventarët	9	41,921,955	37,957,697
Kërkesa të arkëtueshme	10	49,973,314	37,547,134
Aktive të tjera	11	7,821,178	14,349,564
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	12	32,884,283	28,602,946
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>132,640,730</b>	<b>118,497,341</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>476,613,356</b>	<b>470,403,496</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali aksionar	13	2,725,515,000	2,570,940,000
Humbjet e mbartura		(2,682,338,284)	(2,328,319,746)
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>43,176,716</b>	<b>242,620,254</b>
<b>Detyrimet</b>			
Hua afatgjata	14	228,216,859	92,565,000
Detyrime tatimore të shtyra	27	15,186,923	12,723,633
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>243,403,782</b>	<b>105,288,633</b>
Pjesa afatshkurtër e huave afatgjata	14	6,218,197	99,435
Të pagueshme ndaj furnitorëve	15	64,383,529	24,782,243
Detyrime të tjera	16	58,103,151	39,655,583
Detyrimet e lojrave	17	61,327,981	57,957,348
<b>Detyrime afatshkurtra</b>		<b>190,032,858</b>	<b>122,494,609</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>433,436,640</b>	<b>227,783,242</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>476,613,356</b>	<b>470,403,496</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 5 deri ne 31.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Drejtimi i Lotaria Kombëtare sh.p.k. më 16 Qershor 2020 dhe nënshkruar si me poshtë:

Peter Simoner  
CEO



Paul Pialek  
CEO

Dritan Basha  
CFO

**Lotaria Kombëtare sh.p.k****Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor	
		2019	2018
Të ardhura nga lotaritë	18	651,615,770	304,643,942
Të ardhura të tjera		2,138,682	1,228,153
<b>Totali i të ardhurave</b>		<b>653,754,452</b>	<b>305,872,095</b>
Shpenzime marketingu	19	(73,015,472)	(51,537,702)
Shpenzime për çmimet e lotarisë	20	(416,840,424)	(160,882,776)
Shpenzime personeli	21	(109,689,280)	(105,823,823)
Tarifat dhe taksat mbi lojërat e fatit	22	(52,803,590)	(36,912,717)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	6,7,8	(93,697,215)	(88,190,032)
Komisione për agjentët	23	(55,941,732)	(26,138,832)
Shpenzime për materialet	24	(41,168,694)	(21,838,872)
Shpenzime të tjera operative	25	(154,269,618)	(117,168,155)
<b>Rezultati nga veprimtaria operative</b>		<b>(343,671,573)</b>	<b>(302,620,814)</b>
Shpenzime financiare	26	(9,192,635)	(4,171,019)
Të ardhura financiare	26	1,308,960	16,928
<b>Shpenzime financiare, neto</b>		<b>(7,883,675)</b>	<b>(4,154,091)</b>
<b>Humbja para tatim-fitimit</b>		<b>(351,555,248)</b>	<b>(306,774,905)</b>
Shpenzim nga tatimi i shtyrë	27	(2,463,290)	(1,102,783)
<b>Humbja për periudhën</b>		<b>(354,018,538)</b>	<b>(307,877,688)</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi		-	-
<b>Totali i humbjes gjithëpërfshirëse për periudhën</b>		<b>(354,018,538)</b>	<b>(307,877,688)</b>

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare në faqet 5 deri në 31.

**Lotaria Kombëtare sh.p.k**  
**Pasqyra e ndryshimeve në kapital per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Kapitali aksionar	Humbjet e mbartura	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2018</b>	<b>2,570,940,000</b>	<b>(2,020,442,058)</b>	<b>550,497,942</b>
<i><b>Totali humbjes gjithëpërfshirëse për periudhën</b></i>			
Humbja për periudhën	-	(307,877,688)	(307,877,688)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për periudhën	-	-	-
<b>Totali i humbjes gjithëpërfshirëse të periudhës</b>	<b>-</b>	<b>(307,877,688)</b>	<b>(307,877,688)</b>
<b>Transaksionet me pronarët e Shoqërisë, të njohura direkt në kapital</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>2,570,940,000</b>	<b>(2,328,319,746)</b>	<b>242,620,254</b>
<i><b>Totali humbjes gjithëpërfshirëse për periudhën</b></i>			
Humbja për periudhën	-	(354,018,538)	(354,018,538)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për periudhën	-	-	-
<b>Totali i humbjes gjithëpërfshirëse të periudhës</b>	<b>-</b>	<b>(354,018,538)</b>	<b>(354,018,538)</b>
<b>Transaksionet me pronarët e Shoqërisë, të njohura direkt në kapital</b>	<b>154,575,000</b>	<b>-</b>	<b>154,575,000</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>2,725,515,000</b>	<b>(2,682,338,284)</b>	<b>43,176,716</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare, në faqet 5 deri në 31.



**Lotaria Kombëtare sh.p.k**

**Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Shënime	Per vitin e mbyllur më 31 dhjetor	
	2019	2018
<b>Flukse monetare nga aktiviteti operativ</b>		
Humbja para tatim fitimit	(351,555,248)	(306,774,905)
<i>Rregullime për:</i>		
Zhvlerësimin	6,7 42,961,180	37,501,009
Amortizimin	8 50,736,035	50,689,023
Zhvlerësimin e inventarit dhe provizione	9 4,793,521	1,541,750
Vlera kontabël neto e aktiveve të shitura	-	1,564,137
Shpenzime financiare	26 9,192,635	1,654,221
Të ardhura nga interesat dhe të tjera financiare	26 (1)	(16,928)
	<b>(243,871,878)</b>	<b>(213,841,693)</b>
<i>Ndryshimet në:</i>		
Inventarë	9 (6,106,327)	35,668,899
Kërkesa të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	10 (12,426,180)	(12,889,588)
Aktivet e tjera	11 6,528,386	11,953,796
Furnitorë	15 39,601,286	9,740,766
Detyrimet e tjera	16 19,166,749	(22,908,078)
	<b>(197,107,964)</b>	<b>(192,275,898)</b>
Interesa dhe të ardhura të tjera financiare	26 1	14,612
<b>Flukse monetare neto nga aktiviteti operativ</b>	<b>(197,107,963)</b>	<b>(192,261,286)</b>
<b>Flukse monetare nga aktiviteti investues</b>		
Blerje e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	6,7,8 (85,763,685)	(2,011,486)
Të hyra nga shitja e aktiveve të qëndrueshme	-	331,971
<b>Flukse monetare neto të përdorura në aktivitetin investues</b>	<b>(85,763,685)</b>	<b>(1,679,516)</b>
<b>Flukse monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues</b>		
Të hyra nga kapitali i ri i emetuar	154,575,000	-
Shuma të marra nga huatë e reja	14 149,540,233	92,565,000
Ripagimi i huave	(7,769,612)	-
Interesi i paguar	26 (9,192,635)	(1,651,905)
<b>Flukse monetare neto nga aktiviteti financues</b>	<b>287,152,986</b>	<b>90,913,095</b>
<b>Rritja neto /(Pakësimi) në mjete monetare dhe ekuivalente me to</b>	<b>4,281,338</b>	<b>(103,027,707)</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të periudhës</b>	<b>12 28,602,946</b>	<b>131,630,653</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të periudhës</b>	<b>12 32,884,283</b>	<b>28,602,946</b>

Pasqyra e flukseve të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 5 deri në 31.

## **1. Informacion i përgjithshëm**

Lotaria Kombëtare sh.p.k (“Shoqëria”), e quajtur me parë OLG Project sh.p.k u krijua në Shqipëri si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 19 shtator 2012. Adresa e saj është “Rruga Murat Toptani, Qendra e Biznesit Eurocol, Kati 6, Tiranë”, dhe është e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me numër unik identifikimi L22119005R, si filial në pronësi të plotë të Albanisch Österreichische Lotterien Holding Gesellschaft (“Shoqëria mëmë” - direkte), e cila është një shoqëri ‘holding’ me vendndodhje në Gumpoldskirchen, Austri, dhe adresë biznesi në Wiener Straße 158, 2352 Gumpoldskirchen, Austri, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës Tregtare të Vienës nën FN 383662 I, e cila fitoi tenderin për administrimin ekskluziv të Lotarisë Kombëtare në Shqipëri, sipas licencës së dhënë nga Qeveria e Shqipërisë më 19 dhjetor 2012, lëshuar nga Ministria e Financës për një periudhë prej 10 vitesh.

Aktiviteti i regjistruar i Shoqërisë është në veprimtarinë e industrisë së lojërave të fatit. Shoqëria i ka paguar një tarifë për licencën prej 500,000,000 Lek Ministrisë së Financave të Shqipërisë më 15 tetor 2012. Shoqëria administrohet nga Z. Peter Simoner dhe Z. Paul Pialek, administratorët e Shoqërisë.

Marrëveshja e licencës u ratifikua nga Parlamenti dhe ka hyrë në fuqi më 4 mars 2013, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 95/2013 “Për miratimin e marrëveshjes së licencës për lotarinë kombëtare, ndërmjet Ministrisë së Financës, si autoritet i autorizuar dhe ‘Oesterreichische Lotterien GmbH’, përfaqësuar nga ‘OLG Project’ sh.p.k’.

Gjatë vitit 2016, 100% të aksioneve të Österreichische Lotterien Gesellschaft m.b.H. u blenë nga Novomatic Gaming Industries GmbH. Si rezultat, pala e re kontrolluese e Shoqërisë është Novomatic Gaming Industries GmbH. Bazuar në marrëveshjen e shitjes-blerjes së aksioneve, më datë 3 maj 2016, ndërmjet Österreichische Lotterien Gesellschaft m.b.H (“shitësi”) dhe Novomatic Gaming Industries GmbH (“blerësi”), palët ranë dakord të transferonin kontrollin indirekt të Shoqërisë. Kjo u vlerësua si e plotësuar në 30 nëntor 2016, me përmbushjen e kushteve të mbylljes siç është përcaktuar në këtë marrëveshje, në përputhje me aprovimet e kërkuara nga autoritetet përkatëse në Shqipëri si një parakusht për transferimin e pronësisë.

Në 5 Tetor 2018, 100% të aksioneve të Novomatic Gaming Industries GmbH u përthithën nga shoqëria mëmë, Novomatic AG, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit austriak me zyrën e regjistruar në Gumpoldskirchen, Austri

Grupi Novomatic (“Grupi”) është një grup që operon globalisht me një teknologji të integruar të lojërave të fatit dhe zbavitjes, me më shumë se 35 vjet eksperiencë si prodhues i pajisjeve të reja të lojërave inovatore të teknologjisë së lartë. Shoqëria përfundimtare mëmë e Novomatic AG është Novo Invest GmbH, një shoqëri e regjistruar në Wiener Neustadt.

## **2. Baza e përgatitjes**

### **(a) Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare bashkëngjitur janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), të cilat janë baza për raportimin financiar ligjor të Shoqërisë.

### **(b) Baza e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

### **(c) Vlerësimi i drejtimit lidhur me aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar mbi parimin e vijimësisë**

Më 31 dhjetor 2019, Shoqëria ka akumuluar humbje prej 2,682,338,284 Lek (2018: 2,328,319,747 Lek) dhe raporton kapital prej 43,176,716 Lek (2018: kapital prej 242,620,253 Lek). Një pjesë e konsiderueshme e kësaj humbje i atribuohet fazës fillestare, që përfshin investime dhe shpenzime mjaft të larta në marketing, zhvillimeve të tregut dhe performancës së pakënaqshme të produkteve gjatë viteve të para të aktivitetit.

Për të përmbushur nevojat për kapital dhe likuiditet dhe për të vazhduar aktivitetin, Shoqëria Mëmë i ofroi mbështetje financiare Shoqërisë. Në vijim të ndryshimit të pronësisë të përshkruar në shënimin 1, në vitin 2017, kapitali i paguar u rrit me 1,235,610,000 Lek dhe huatë nga bankat u ripaguan plotësisht. Në dhjetor të vitit 2017, ka ndodhur një injektim tjetër i kapitalit në shumën prej 133,380,000 Lek. Gjatë vitit 2019 u bë një shtesë tjetër kapitali me vlerë 154,575,000 Lek. Kapitali aksionar i paguar më 31 Dhjetor 2019 ishte 2,725,515,000 Lek.

Në vijim të ndryshimit të pronësisë, Shoqëria ka rishikuar strategjinë e biznesit dhe strukturën operacionale, duke e përshtatur atë më shumë me nevojat e tregut lokal dhe duke optimizuar portofolin e produkteve. Shoqëria Mëmë nuk ka për qëllim likuidimin apo mbylljen e aktivitetit në një të ardhme të afërt dhe Mëma do vazhdojë ta mbështesë aktivitetin në Shqipëri financiarisht.

**2. Baza e përgatitjes (vazhdim)**

**(c) Vlerësimi i drejtimit lidhur me aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar mbi parimin e vijimësisë (vazhdim)**

Drejtimi beson se Shoqëria do jetë në gjendje të minimizojë humbjet për gjatë viteve në vijim duke optimizuar kostot dhe gjenerojë të ardhura ne te ardhmen dhe aftësia e saj për të vazhduar mbi parimin e vijimësisë nuk do të rrezikohet. Për këtë arsye, Shoqëria i ka përgatitur këto pasqyra financiare mbi parimin e vijimësisë.

**(d) Monedha funksionale dhe raportuese**

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale për Shoqërinë.

**(e) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në çdo periudhë të ardhshme të ndikuar. Në mënyrë të veçantë, informacioni rreth fushave të rëndësishme të vlerësimeve të pasigurta dhe të gjykimeve kritike në zbatimin e IFRS-ve, të cilat kanë ndikimin më të madh në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimin 4.

**3. Politika kontabël të rëndësishme**

Politikat kontabël më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

**(a) Aktive afatgjata materiale**

*(i) Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale, paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shiko më poshtë) dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit.

Në rastet kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të veçantë (përbërësit më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimi ose humbja nga shitja apo nxjerrja jashtë përdorimit të një zëri të aktiveve afatgjata materiale përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e kontabël dhe njihen në vlerë neto në të ardhura të tjera/humbje të tjera operative dhe përfshihen në fitim ose humbje.

*(ii) Kostot vijuese*

Kosto e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbetur të atij zëri nëse është e mundur që Shoqëria do të ketë përfitime të ardhshme ekonomike nga pjesa zëvendësuese dhe kosto e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme ndaj aktiveve afatgjata materiale njihen si në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

*(iii) Amortizimi*

Amortizimi pasqyrohet në fitim ose humbje bazuar në metodën lineare mbi jetëgjatësinë e parashikuar të aktiveve afatgjata materiale nga data kur ato janë gati për përdorim.

Jetëgjatësitë e parashikuara janë si më poshtë:

Pajisje TI	3-8 vite
Pajisje të lojërave të fatit	10 vite
Makina	5 vite
Mobilje dhe pajisje zyre	5 vite
Të tjera	5 vite

Përmirësimi i ambienteve të marra me qira amortizohen mbi jetëgjatësinë më të shkurtër midis kohëzgjatjes së qirasë dhe jetës së dobishme, përveç rasteve kur është e sigurt se Shoqëria do të marre në pronësi aktivin në fund të afatit të qirasë. Në këto raste amortizimi llogaritet mbi jetëgjatësinë e parashikuar të aktivitetit.

### **3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)**

Metodat e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe përshtaten nëse është e nevojshme.

#### **(b) Aktivet afatgjata jo-materiale**

Aktivitet afatgjata jo-materiale të blera nga Shoqëria paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi (nëse ka). Amortizimi njihet në fitim ose humbje me metodën lineare mbi jetëgjatësinë e parashikuar të aktiveve afatgjata jo materiale nga data në të cilën ato janë të disponueshme për përdorim. Jetëgjatësia e parashikuar e përdorimit është si më poshtë:

Programe Kompjuterike	4 vite
Licensa	10 vite

#### **(c) Inventarët**

Inventarët janë matur me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e inventarëve llogaritet bazuar në parimin ("FIFO") për biletat gërvishëse, ndërsa për pjesën e mbetur të inventarit, përdoret parimi i koston mesatare të ponderuar dhe përfshin koston e blerjes, koston e shndërrimit dhe gjithë koston e tjera për të sjellë inventarët në vendndodhjen dhe në kushtet aktuale. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes përgjatë aktivitetit normal të Shoqërisë, minus koston e vlerësuar të përfundimit të shitjes.

#### **(d) Qiraja**

Vlerësimi nëse një kontratë është ose përmban qira bazohet në substancën e marrëveshjes në datën e fillimit të kontratës, nëse përmbushja e kontratës varet nga përdorimi i një aktivi ose aktiveve specifike ose kontrata jep të drejtën e përdorimit të një aktivi edhe nëse ky aktiv nuk specifikohet në kontratë.

#### *Shoqëria si qiramarrës*

Qiramarrjet trajtohen me 'modelin e të drejtës së përdorimit'. Qiratë të cilat transferojnë tek Shoqëria në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e rastësishme nga pronësia e aktivitet të marrë me qira, kapitalizohen në fillimin e qirasë me vlerën e drejtë të aktivitet të marrë me qira. Pagesat e qirasë ndahem midis shpenzimit të interesit dhe zvogëlimit të detyrimit të qirasë në mënyrë që të arrihet një normë e pandryshueshme e interesit për pjesën e mbetur të detyrimit. Tarifat e interest njihen në shpenzimet financiare në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse.

Një aktiv i marrë me qira amortizohet përgjatë jetës së dobishme të aktivitet. Sidoqoftë, nëse nuk ka siguri të arësyeshme që shoqëria do të marrë pronësinë në përfundim të afatit të qirasë, aktivi do të amortizohet përgjatë afatit më të shkurtër midis jetës së dobishme dhe kohëzgjatjes së marrëveshjes së qirasë.

Pagesat për qira afatshkurtra me afat më pak ose deri në 12 muaj njihen si shpenzime operative në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse në bazë lineare gjatë afatit të qirasë. Në mënyrë të ngjashme trajtohen edhe qiratë e aktiveve me vlerë të ulët deri në 5,000 Euro kur janë të reja. Aktivitet me vlerë të ulët përfshijnë kompjutera desktop dhe laptop, mobilje të vogla zyre, telefona dhe pajisje të tjera me vlerë të ulët dhe përjashtohen këtu automjetet pasi ato zakonisht nuk do të kishin një vlerë më të ulët kur janë të reja.

#### **(e) Instrumentet financiare**

Shoqëria zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative.

##### *(i) Aktive financiare jo-derivative*

Shoqëria fillimisht njeh llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat në datën në të cilën janë krijuar. Të gjitha aktivitet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, datë në të cilën Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Shoqëria çregjistron aktivitet financiare nëse të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose nëse ajo i transferon të drejtat për të arkëtuar flukse nga aktivi financiar një pale tjetër, duke transferuar në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin. Çdo interes në aktivitet financiare të transferuara që krijohet ose mbahet nga Shoqëria njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Aktivitet dhe detyrimet financiare netohen së bashku dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka të drejtë ligjore për ti kompensuar shumat dhe ka për qëllim ose shlyerjen me vlerë neto, ose të realizojë shitjen e aktivitet dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht.

### **3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)**

#### **(e) Instrumentet financiare (vazhdim)**

##### *(ii) Mjete monetare dhe ekuivalente*

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë mjetet monetare në arkë, depozita afatshkurtra bankare, të tjera investime afatshkurtër me likuiditet të lartë me maturitet fillestar deri në tre muaj ose më pak, për të cilat rreziku i një ndryshimi në vlerën e drejtë është i pakonsiderueshëm, dhe Shoqëria i përdor për menaxhimin e angazhimeve të saj afatshkurtra.

##### *(iii) Kërkesa të arkëtueshme*

Kërkesat e arkëtueshme janë aktive financiare me pagesa fikse ose të përcaktuara, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive. Këto aktive njihen fillimisht me vlerë të drejtë plus kosto direkte të transaksionit. Në vazhdim, llogaritë e arkëtueshme e të tjera të arkëtueshme maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi (shih shënimin 3)(f)(i)).

##### *(iv) Detyrime financiare jo-derivative*

Shoqëria i njeh fillimisht detyrimet financiare, në datën e tregtimit në të cilën Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit. Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo kanë përfunduar.

##### *(iv) Detyrime financiare jo-derivative (vazhdim)*

Aktivitet dhe detyrimet financiare netohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka të drejtë ligjore për të netuar shumat dhe synon ose të shlyejë mbi bazën neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Shoqëria ka këto detyrime financiare jo-derivative: huatë, detyrimet të tjera dhe te pagueshme ndaj furnitorëve.

Detyrime të tilla financiare njihen fillimisht me vlerë të drejtë plus çdo kosto të drejtpërdrejtë të transaksionit. Pas njohjes fillestare, këto detyrime financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Kontabilizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare është diskutuar në politikën kontabël 3(n).

##### *(v) Kapitali aksionar*

Kapitali i Shoqërisë është njohur me vlerën nominale.

#### **(f) Zhvlerësimi**

##### *(i) Aktivitet financiare*

Një aktiv financiar jo i mbajtur me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes vlerësohet në fund të çdo periudhe raportuese, për të përcaktuar nëse ka evidencë objektive për ta zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive që tregon se një ose disa ngjarje kanë ndikim negativ në flukset e ardhshme të parashikuara të atij aktivi dhe kjo mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Evidenca objektive që aktivitetet financiare janë zhvlerësuar mund të përfshijë pamundësi apo vështirësi të një klienti për të realizuar pagesën, ristrukturim të një detyrimi ndaj Shoqërisë me kushte që Shoqëria nuk do t'i merrte në konsideratë në rast të tjera, ose tregues që një klient do të shpallë falimentim.

Humbja nga zhvlerësimi i aktiveve financiare me kosto të amortizuar, matet si diferencë midis vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të flukseve të pritshme të skontuar me normën fillestare efektive. Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në baza individuale. Aktivitetet financiare të mbetura vlerësohen kolektivisht në grupe të cilat kanë karakteristika të njëjta të rrezikut të kreditimit.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimet njihen në fitim ose humbje. Humbja nga zhvlerësimi kthehet (rimerrret), nëse kthimi ka lidhje objektive me një ngjarje të ndodhur pasi është njohur humbja nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me koston e amortizimit, kthimi njihet në fitim ose humbje.

*(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

**3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)**

**(f) Zhvlerësimi (vazhdim)**

*(ii) Aktive jo-financiare*

Vlera kontabël e aktiveve financiare të Shoqërisë, përveç inventarit dhe aktiveve tatimorë të shtyrë, rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka tregues për zhvlerësim. Nëse ekziston një tregues i tillë, atëherë vlerësohet shuma e rikuperueshme e aktivitetit. Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e aktivitetit ose njësisë gjeneruese të mjeteve monetare (NJGJMM) tejkalon vlerën e rikuperueshme.

Shuma e rikuperueshme e aktivitetit ose NJGJMM është më e madhja midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet specifike të aktivitetit ose NJGJMM. Për testimin e zhvlerësimit, aktivitetet grupohen së bashku në grupet më të vogla të aktiveve që gjeneron flukse monetare hyrëse nga përdorimi i vazhdueshëm, të cilat janë të pavarura nga flukset monetare hyrëse të aktiveve të tjera ose NJGJMM.

Humbja nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje. Humbja nga zhvlerësimi kthehet (rimerrret), deri në nivelin kur vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që duhet të kishte patur aktivi duke zbritur amortizimin, nëse humbja nga zhvlerësimi nuk do ishte njohur ndonjëherë.

**(g) Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat njihen fillimisht me vlerën e drejtë të shumës së arkëtueshme neto nga skontot dhe zbritjet.

Të ardhurat nga biletat e shitura tek konsumatorët për lojërat e fatit, për të cilat rezultati përcaktohet bazuar në një short njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në momentin që shorti hidhet. Kur lojtarët luajnë një shumë në avancë, kjo e ardhur shtyhet dhe njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse atëherë kur shorti përkatës realizohet.

Të ardhurat nga biletat gërvishtëse njihen kur janë bërë të disponueshme për shitje tek publiku, moment në të cilin bëhet aktivizimi i biletave në sistem.

Të ardhurat nga interesi njihen në bazë të përlllogaritjes kur fitohen dhe raportohen në periudhën financiare me të cilën lidhet.

**(h) Çmimet e lotarisë**

Lojrat me bazë shorti “Loto 6 nga 39” dhe “Keno” janë organizuar në bazë të një mekanizmi çmimesh sipas të cilit një përqindje e paracaktuar nga biletat e shitura alokohet për fondin e çmimeve. Deri në vitin 2017 detyrimi për çmimet është njohur plotësisht në momentin e realizimit të shortit. Duke filluar nga 1 Janari 2018 Shoqëria i nje detyrimet e lojës në momentin që çmimet fitohen.

Në masën që çmimet e fituara prej shorteve në “Loto 6 nga 39” dhe “Keno”, ndryshojnë nga përqindja e paracaktuar e çmimeve, çmimet përkatëse mbarten në fondin për çmimet e ardhshme.

Deri në fundin të vitit 2017 çmimet për biletat gërvishtëse janë njohur përqindje ndaj shitjeve në përputhje me piramidën teorike të pagesave për çmimet. Duke filluar nga 1 Janari 2018 çmimet e biletave gërvishtëse njihen kur çmimet fitohen aktualisht.

Çmimet e fituara por të pa tërhequra në lojën kombëtare” Loto 6 nga 39” për më shumë se 90 ditë, rikthehen në lojë nëpërmjet “jackpot-eve” të garantuara dhe çmimeve promovuese në përputhje me rregullat e lojërave të fatit të aprovuara nga autoriteti rregullator.

**(i) Komisionet dhe bonuset**

Komisionet dhe bonuset e njohura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse përfaqësojnë komisione të cilat shkaktohen si pasojë: (i) e normave fikse mbi shitjet e bëra prej rishitësve dhe; (ii) shpërblime dhe bonuse të tjera të lidhura me shitjet. Kur një komision i paguhet një agjenti për shitjen e biletave të cilat i përkasin shorteve të ardhshëm, kjo shumë regjistrohet si shpenzim i parapaguar derisa e ardhura përkatëse të njihet.

*(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

**3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)**

**(j) Shpenzimet operative**

Shpenzimet operative njihen kur ato ndodhin.

**(k) Përfitimet e punonjësve**

*(i) Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore*

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitime në trajta pensioni për punonjësit kur dalin në pension. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për përcaktimin e limitit ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani të përcaktuar kontributesh pensioni. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

*(ii) Pagesat për lejet vjetore*

Shoqëria njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të vlerësuara në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhen në këmbim për shërbimin e punonjësve gjatë periudhës së mbyllur.

**(l) Provizionet**

Një provizion njihet kur Shoqëria, si pasojë e ngjarjeve të shkuara ka një detyrim aktual, ligjor ose konstruktiv, që mund të matet në mënyre të besueshme, dhe është e mundur që të kërkohet një fluks dalës të përfitimeve ekonomike për të shlyer detyrimin. Provizionet llogariten duke skontuar flukset e ardhshme monetare me një normë përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të pasasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Amortizimi i skontos njihet si kosto financiare.

**(m) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat nga fondet e investuara në banka dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Te ardhurat nga interesat njihen kur përfitohen, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi, komisione bankare dhe humbjet nga kursi i këmbimit. Fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit prezantohen neto si e ardhur ose shpenzim financiar në varësi të faktit nëse lëvizjet në kursin e këmbimit rezultojnë në një pozicion neto fitimi apo humbje.

**(n) Tatimi mbi lojërat e fatit**

Bazuar në marrëveshjen e licencës me Qeverinë e Shqipërisë, Shoqëria është e detyruar të paguajë detyrime tatimore bazuar mbi totalin e qarkullimit bruto si me poshtë:

- Tatim mbi lojërat e fatit prej 15% (Fitimit të mbetur nga loja) GGR;
- Tarifë kontributi për çështjet e mira prej 2.2% të xhiros;
- Tarifë administrimi për njësinë e mbikëqyrjes së lojërave të fatit në masën 0.5% të xhiros, por jo më pak se 2,000,000 Lek në vit.

*(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

**3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)**

**(o) Tatimi mbi fitimin**

Shpenzimi i tatim fitimit përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale dhe ai i shtyrë njihen në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet ose të arkëtohet mbi fitimin apo humbjen e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara ose që do të miratohen në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme. Drejtimi vlerëson periodikisht pozicionin e marrë në deklaratat e raportuara tatimore presa i përket situatave në të cilat rregullorja e aplikueshme tatimore përbën subjekt interpretimi. Aty ku është e përshtatshme, drejtimi përcakton provizionim bazuar në shumat e pritshme për t'u paguar autoriteteve tatimore.

Tatimi i shtyrë njihet mbi diferencat e përkohshme midis vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë llogaritet me normat e tatimit që priten të aplikohen mbi diferencat e përkohshme në periudhën kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin në fuqi ose që pritet të hyjë në fuqi deri në datën e raportimit.

Aktivet dhe pasivet tatimore të shtyra netohen nëse ekziston një e drejtë ligjore për të netuar detyrimet dhe aktivet aktuale, dhe ato lidhen me tatimin mbi të ardhurat që përcakton i njëjti autoritet tatimor.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për humbjet fiskale të papërdorura, kreditime tatimore dhe diferenca të përkohshme të zbritshme në masën që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ato të mund të përdoren. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më e mundur që përfitimi tatimor përkatës të realizohet.

Shoqëria njih një aktiv tatimor të shtyrë mbi humbjet tatimore të mbartura në masën që është e mundur që këto humbje mund të përdoren kundrejt një fitimi të tatueshëm të ardhshëm.

**(p) Transaksionet dhe balancat në valutë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në fuqi në datat e transaksioneve. Aktivet dhe detyrimet të shprehura në valutë të huaj në datën e raportimit janë përkthyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit, në atë datë. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten në termat e kostos historike përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga përkthimi njihen në fitim ose humbje. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit paraqiten në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në 'Të ardhura/(shpenzime) financiare, neto'.



*(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

### **3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)**

#### **(r) Standarde të reja, interpretime dhe ndryshime efektive ne periudhen aktuale**

Politikat kontabël të adoptuara janë konsistente me politikat e vitit të mëparshëm me përjashtim të SNRF-ve të ndryshuara, të cilat janë adoptuar nga Shoqëria në datën 1 janar 2019:

- **SNRF 16 Qiratë**
- **KIRFN 23 Interpretimi - Pasiguria mbi trajtimin e tatimit mbi te ardhurat**
- **Ndryshime të SNRF 9: Elementë parapagimi me kompensim negativ**
- **Ndryshimet në SNK 19: Ndryshime të skemës, shkurtimet, ose shlyerja**
- **Ndryshimet në SNK 28: Interesat afatgjatë në pjesëmarrjet dhe sipërmarrjet e përbashkëta**
- **Përmirësimet vjetore të SNRF-ve: cikli 2015-2017**

Këto standarde dhe ndryshime të reja janë aplikuar për herë të parë duke filluar nga 1 Janar 2019. Natyra dhe ndikimi i çdo standardi dhe ndryshimi është përshkruar si vijon:

#### **- SNRF 16 Qiratë**

BSNK publikoi standardin e ri për kontabilizimin e qirave - SNRF 16 Qiratë në Janar 2016. Standardi i ri nuk ndryshon shumë kontabilizimin e qirave nga qiradhënesit. Megjithatë, kërkon që qiramarrësit të njohin në bilancin e tyre kontabël pothuajse të gjitha qiratë si detyrime për qira bashkë me aktivet korresponduese në aktiv. Qiramarrësit duhet të përdorin një model të vetëm për njohjen e të gjitha qirave, por do të kenë opsionin të mos njohin qiratë afatshkurtra ose qiratë për aktive me vlera të vogla. Në përgjithësi, modeli i njohjes do jetë i ngjashëm me atë që përdoret aktualisht për kontabilizimin e qirave financiare, me interesin dhe shpenzimin e amortizimit të njohur në zëra të vecantë në pasqyrën së fitimit ose humbjes. SNRF 16 hyn në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Janar 2019. Natyra dhe efekti i ndryshimeve si rezultat i adoptimit të këtij standardi të ri kontabël përshkruhet më poshtë. Shoqëria e ka adoptuar SNRF 16 duke përdorur metodën e modifikuar retrospektive me datë fillestare aplikimi të standardit datën 1 Janar 2019. Me metodën e modifikuar (alternativa 2) detyrimi i qirasë njihet gjiashtu bazuar në pagesat e skontuara me normën rritëse të huamarrjes të qiramarrësit në datën e adoptimit.

Shoqëria gjithashtu zgjodhi të përdorë përjashtimet e njohjes për kontratat e qirasë që në datën e fillimit kanë një afat të mbetur prej 12 muajsh ose më pak dhe nuk kanë një opsion blerje në përfundim të kontratës (kontratat afatshkurtra), dhe qiratë për të cilat vlera e aktivitetit është vlerë e ulët.

Më 1 Janar 2019:

- ‘Aktivet me të drejtë përdorimi’ janë njohur dhe prezantuar vecmas në pasqyrën e pozicionit financiar (Shënimi 7).
- Aktivitetet e qirasë financiare (automjetete) të njohura më parë nëpërmjet qirasë financiare, të cilat ishin përfshirë në ‘Aktivet afatgjatë materiale’, janë njohur në ‘Aktivet me të drejtë përdorimi’.
- ‘Fitimet e mbartura’ nuk janë ndikuar nga adoptimi i këtyre ndryshimeve.

Më 31 Dhjetor 2019

- ‘Aktivet me të drejtë përdorimi’ janë prezantuar vecmas në Pasqyrën e pozicionit financiar (Shënimi 7).
- Detyrimet shtesë të njohura janë përfshirë në zërin ‘Hua’.
-

### **3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)**

#### **(r) Standarde të reja, interpretime dhe ndryshime efektive në periudhën aktuale (vazhdim)**

##### **- KIRFN 23 Interpretimi - Pasiguria mbi trajtimin e tatimit mbi të ardhurat**

Interpretimi trajton kontabilitetin për tatimin mbi të ardhurat kur trajtimet tatimore përfshijnë pasiguri që ndikojnë në zbatimin e SNK 12 dhe nuk zbatohet për tatimet ose taksat jashtë fushëveprimit të SNK 12 dhe as nuk përfshin në mënyrë specifike kërkesa lidhur me interesa dhe penalitete që lidhen me trajtimin e pasigurt tatimor. Interpretimi trajton në mënyrë specifike sa vijon:

- Nëse një njësi ekonomike i konsideron trajtimet e pasigurta tatimore veç e veç.
- Supozimet që një njësi ekonomike bën në lidhje me ekzaminimin e trajtimeve tatimore nga autoritetet tatimore
- Si një njësi ekonomike përcakton fitimin e tatueshëm (humbje tatimore), bazat tatimore, humbjet tatimore të papërdorura, kreditë tatimore të papërdorura dhe normat tatimore
- Si një njësi ekonomike i konsideron ndryshimet në fakte dhe rrethana.

Një njësi ekonomike duhet të përcaktojë nëse duhet të konsiderojë çdo trajtim tatimor të pasigurt veçmas ose së bashku me një ose më shumë trajtime të tjera të pasigurta tatimore. Duhet të ndiqet qasja që parashikon më mirë zgjidhjen e pasigurisë. Interpretimi është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019. Ky ndryshim nuk ka efekt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

##### **- Ndryshime të SNRF 9: Elementë parapagimi me kompensim negativ**

Sipas SNRF 9, një instrument borxhi mund të matet me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, me kusht që flukset monetare kontraktuale të jenë “vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën e principalit të mbetur” (kriteri i SPPI) dhe instrumenti mbahet brenda një model biznesi të përshtatshëm për këtë klasifikim. Ndryshimet në SNRF 9 sqarojnë se një aktiv financiar kalon kriterin e SPPI pavarësisht nga ngjarja ose rrethana që shkakton ndërprerjen e parakohshme të kontratës dhe pavarësisht se cila pale paguan ose merr kompensim të arsyeshëm për përfundimin e parakohshëm të kontratës. Ndryshimet duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive dhe hyjnë në fuqi që nga 1 janari 2019, aplikimi i më hershëm është i lejuar. Ky ndryshim nuk ka efekt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

##### **- Ndryshimet në SNK 19: Ndryshime të skemës, shkurtimet, ose shlyerja e planit**

Ndryshimet në SNK 19 adresojnë kontabilitetin kur ndodh një ndryshim, shkurtim ose shlyerje plani gjatë një periudhe raportuese. Ndryshimet e standardit specifikojnë se kur një ndryshim, shkurtim ose shlyerje plani ndodh gjatë periudhës raportuese vjetore, një njësi ekonomike duhet të:

- Përcaktojë koston aktuale të shërbimit për pjesën e mbetur të periudhës pas ndryshimit të skemës, shkurtimit ose shlyerjes, duke përdorur supozimet aktuariale të përdorura për rivlerësimin e detyrimit (aktivin) neto të përfitimit të përcaktuar që reflekton përfitimet e ofruara sipas skemës dhe aktivet e skemës pas asaj ngjarjeje
- Përcaktojë interesin neto për pjesën e mbetur të periudhës pas ndryshimit, shkurtimit ose shlyerjes të skemës duke përdorur: detyrimin (aktivin) neto të përfitimeve të përcaktuara që pasqyrojnë përfitimet e ofruara sipas skemës dhe aktiveve të skemës pas asaj ngjarjeje; dhe normën e skontimit të përdorur për të rimatur atë detyrim (aktiv) neto të përfitimeve të përcaktuara.

Ndryshimet gjithashtu sqarojnë se një njësi ekonomike përcakton së pari çdo kosto të shërbimit të shkuar, ose një fitim ose humbje nga shlyerja, pa marrë parasysh efektin e tavanit të aktivitetit. Kjo shumë njihet në fitim ose humbje. Një njësi ekonomike pastaj përcakton efektin e tavanit të aktivitetit pas ndryshimit, shkurtimit ose shlyerjes të skemës. Çdo ndryshim në këtë efekt, duke përfshirë shumën e përfshira në interesin neto, njihet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Ndryshimet zbatohen për ndryshimet, shkurtimet ose shlyerjen e planit që ndodhin në ose pas fillimit të periudhës së parë të raportimit vjetor që fillon më ose pas 1 janarit 2019. Ky ndryshim nuk ka efekt në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Ky ndryshim mund të aplikohet në ndryshime, shkurtime ose shlyerje të mëvonshme të skemës nga Shoqëria.

**3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)**

**(q) Standarde të reja, interpretime dhe ndryshime efektive në periudhën aktuale (vazhdim)**

**- Ndryshimet në SNK 28: Interesat afatgjata në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta**

Ndryshimet sqarojnë që një njësi ekonomike zbaton SNRF 9 për interesat afatgjatë në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët në të cilën nuk aplikohet metoda e kapitalit neto, por që në thelb përbën një pjesë të investimit neto në pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët (interesa afatgjatë). Ky sqarim është i rëndësishëm sepse nënkupton që modeli i prituri i humbjes së kredisë në SNRF 9 zbatohet për interesa të tilla afatgjata. Ndryshimet gjithashtu sqaruan se, në zbatimin e SNRF 9, një njësi ekonomike nuk merr parasysh humbjet e pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët, ose ndonjë humbje nga zhvlerësimi në investimet neto, të njohura si rregullime të investimit neto në pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët që lindin nga zbatimi i SNK 28 Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta. Amendamentet duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive dhe janë në fuqi nga 1 janari 2019. Meqenëse Shoqëria nuk ka interesa të tilla afatgjata në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta, ndryshimet nuk kanë ndikim në pasqyrat e saj financiare.

**- Përmirësime vjetore të SNRF-ve, Cikli 2015-2017 (leshuar në Dhjetor 2017)**

Këto përmirësime përfshijnë:

**- SNRF 3 Kombinimet e biznesit**

Ndryshimet sqarojnë se kur një njësi ekonomike merr kontrollin e një biznesi që është një operacion i përbashkët, ajo zbaton kërkesat e një kombinimi biznesi të arritur në fazë, duke përfshirë rivlerësimin e interesave të mbajtura më parë në aktivet dhe pasivet e operacioneve të përbashkëta me vlerë të drejtë. Duke vepruar kështu, blerësi e rimat të gjithë interesin e mbajtur më parë në operacionin e përbashkët. Një njësi ekonomike zbaton këto ndryshime në kombinimet e biznesit për të cilat data e blerjes është në ose pas fillimit të periudhës së parë të raportimit vjetor që fillon më ose pas 1 janarit 2019. Këto ndryshime do të zbatohen për kombinimet e ardhshme të biznesit të Shoqërisë.

**- SNRF 11 Marrëveshjet e përbashkëta**

Një palë që merr pjesë, por nuk ka kontroll të përbashkët në një operacion të përbashkët, mund të marrë kontroll të përbashkët të veprimtarisë e cila përbën një biznes siç përcaktohet në SNRF 3. Amendamentet sqarojnë se interesat e mbajtura më parë në atë operacion të përbashkët nuk rimaten. Një njësi ekonomike zbaton këto ndryshime në transaksionet në të cilat ajo fiton kontroll të përbashkët në ose pas fillimit të periudhës së parë të raportimit vjetor që fillon në ose pas 1 janarit 2019. Këto ndryshime aktualisht nuk janë të zbatueshme për Shoqërinë, por mund të zbatohen për transaksionet e ardhshme.

**- SNK 12 Tatimi mbi Fitimin**

Ndryshimet sqarojnë se pasojat e tatimit mbi të ardhurat e dividendëve lidhen më drejtpërdrejt me transaksionet e mëparshme ose ngjarjet që gjenerojnë fitime të shpërndara sesa me shpërndarjet tek pronarët. Prandaj, njësi ekonomike njeh pasojat e tatimit mbi të ardhurat e dividendëve në fitim ose humbje, të ardhura të tjera gjithëpërfshirë ose kapital sipas menyres se ku njësi ekonomike fillimisht i ka njohur ato transaksione ose ngjarje të mëparshme. Njësi ekonomike zbaton këto ndryshime për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019. Kur një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për here te pare, ajo i zbaton ato tek tatimi mbi të ardhurat i dividendëve të njohur në ose pas fillimit të periudhës më të hershme krahasuese. Këto ndryshime aktualisht nuk janë të zbatueshme për Shoqërinë, por mund të zbatohen për transaksionet e ardhshme.

**3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)**

**(r) Standarde të reja, interpretime dhe ndryshime efektive në periudhën aktuale (vazhdim)**

**- SNK 23 Kostot e Huamarrjes**

Ndryshimet sqarojnë që një njësi ekonomike trajton si pjesë e huamarrjes së përgjithshme çdo huamarrje të bërë fillimisht për të zhvilluar një aktiv të kualifikuar kur në tërësi të gjitha aktivitetet e nevojshme për përgatitjen e atij aktivi për përdorimin ose shitjen e synuar janë të perfunduara. Një njësi ekonomike zbaton këto ndryshime në kostot e huamarrjes të bëra në ose pas fillimit të periudhës raportuese vjetore në të cilën njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime. Një njësi ekonomike zbaton këto ndryshime për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë në ose pas 1 janarit 2019. Këto ndryshime aktualisht nuk janë të zbatueshme për Shoqërinë, por mund të zbatohen për transaksionet e ardhshme.

**- Ligji i ri për Kontabilitetin në Shqipëri**

Në vijim të punës që po bën qeveria shqiptare në rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar më datë 10 maj 2018 ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” (më poshtë “Ligji i ri për kontabilitetin” ose “Ligji i ri”), i cili shfuqizon ligjin e mëparshëm nr. 9228, datë 29.4.2004. Ligji i ri për kontabilitetin është përafuar pjesërisht me Direktivën 2013/34 të Bashkimit Evropian dhe qëllimi është përafrimi i plotë i tij në vitin 2028. Ligji i ri hyri në fuqi më datë 1 janar 2019. Aplikimi i Ligjit të ri nuk ka ndikim në pozicionin financiar dhe performancën e Shoqërisë dhe në mënyrën e parqitjes së pasqyrave financiare.

**(s) Standarde dhe interpretime të reja që nuk kanë hyrë ende në fuqi dhe ende nuk janë zbatuar përpara datës efektive**

Standardet dhe interpretimet e emetuara, por që nuk kanë hyrë ende në fuqi, deri në datën e deklarimit të pasqyrave financiare të Shoqërisë, janë pasqyruar më poshtë. Shoqëria synon të adoptojë këto standarde, nëse janë të aplikueshme, kur ato të bëhen efektive.

**- SNRF 17 Kontratat e sigurimit**

Në Maj 2017, BSNK publikoi SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (SNRF17), një standard i ri kontabël gjithpërfshirës për kontratat e sigurimeve që mbulon njohjen dhe matjen, prezantimin dhe shënimet shpjeguese. Pasi të bëhet efektiv, SNRF 17 do të zëvendësojë SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve (SNRF 4) që është nxjerrë në vitin 2005. SNRF 17 zbatohet për të gjitha llojet e kontratave të sigurimit (dmth., jetë, jo-jetë, sigurimi i drejtpërdrejtë dhe risigurimi), pavarësisht nga lloji i subjekteve që i lëshojnë ato, si dhe për disa garanci dhe instrumente financiare me karakteristika të pjesëmarrjes diskrecionare. Do të ketë disa përygjatime nga objektivi. Objektivi i përgjithshëm i SNRF 17 është të sigurojë një model kontabiliteti për kontratat e sigurimit që të jetë më i dobishëm dhe i qëndrueshëm për siguresit. Në kontrast me kërkesat e SNRF 4, të cilat bazohen kryesisht në politikat e mëparshme të kontabilitetit, SNRF 17 ofron një model gjithpërfshirës për kontratat e sigurimeve, duke mbuluar të gjitha aspektet përkatëse të kontabilitetit. SNRF 17 hyn në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Janar 2021 dhe zbatimi i tij kërkon paraqitjen e vlerave krahasuese të periudhave të mëparshme. Aplikimi i më hershëm është i lejueshëm me kusht që Shoqëria të aplikojë SNRF 9 dhe SNRF 15 më ose përpara datës së aplikimit të SNRF 17. Ky standard nuk është i aplikueshëm për Shoqërinë.

**- Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8: Përkufizimi i materialitetit**

Në tetor 2018, BSNK publikoi ndryshimet e SNK 1 Paraqitja e pasqyrave financiare dhe SNK 8 Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet për të përafuar përkufizimin e ‘materialitetit’ ndërmjet standardeve dhe për të sqaruar disa aspekte të përkufizimit. Përkufizimi i ri shprehet se ‘informacioni është material nëse përjashtimi, deklarimi i gabuar ose fshehja e tij mund të ndikojë në menyrë të arësyeshme vendimet që përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare të përgjithshme marrin bazuar në ato pasqyra financiare, të cilat japin informacion mbi një njësi specifike.

*(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

**3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)**

**(s) Standarde dhe interpretime të reja që nuk kanë hyrë ende në fuqi dhe ende nuk janë zbatuar përpara datës efektive (vazhdim)**

**- Ndryshimet në SNRF 3: Përkufizimi i biznesit**

Në tetor 2018, BSNK publikoi ndryshimet në përkufizimin e biznesit në SNRF 3 Kombinimet e biznesit për të ndihmuar njësitë të përcaktojnë nëse një set aktivesh të përvetësuar përbën një biznes ose jo. Aty sqarohet minimumi i kërkesave për një biznes, hiqet vlerësimi nëse një pjesëtar i tregut është në gjëndje të zëvendësojë ndonjë element që mungon, dhe shtohen udhëzimet për të ndihmuar njësitë të vlerësojnë nëse një proces i përvetësuar është thelbësor, ngushton përkufizimet e biznesit dhe rezultateve, dhe prezanton një test opsional të përqendrimit të vlerës së drejtë. Shembuj të rinj ilustrues janë prezantuar bashkë me ndryshimet. Meqë ndryshimet aplikohen në mënyrë prospektive në transaksionet ose ngjarjet që ndodhin në ose pas datës së parë të aplikimit Shoqëria nuk do të ndikohet nga këto ndryshime në datën e tranzicionit.

**- Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28: Shitja ose kontributi i Aktiveve nga investitori tek pjesëmarrja e tij ose sipërmarrja e përbashkët**

Ndryshimet adresojnë konfliktin midis SNRF 10 dhe SNK 28 për trajtimin e humbjes së kontrollit mbi një filial që shitet ose kontribuohet tek një pjesëmarrje ose sipërmarrje e përbashkët. Ndryshimet sqarojnë se fitimi ose humbja që rezulton nga shitja ose kontributi i aktiveve që përbëjnë një biznes, siç përcaktohet në SNRF 3, nga investitori tek pjesëmarrja e tij ose sipërmarrja e përbashkët, njihet plotësisht. Çdo fitim ose humbje që rezulton nga shitja ose kontributi i aktiveve që nuk përbëjnë një biznes, njihet vetëm në masën e interesave të investitorëve të palidhur në pjesëmarrjen ose sipërmarrjen e përbashkët. BSNK ka shtyrë datën efektive të këtyre ndryshimeve për një kohë të pacaktuar, por një njësi ekonomike që i aplikon ndryshimet me heret duhet t'i zbatojë ato në mënyrë prospektive. Drejtimi ka vlerësuar se adoptimi i këtij ndryshimi nuk do të ketë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Shoqëria ka zgjedhur të mos i implementojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Shoqëria parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë në periudhën e aplikimit fillestar.

**4. Gjykime dhe vlerësime të rëndësishme**

Një numër i politikave dhe paraqitjeve kontabël të Shoqërisë kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejte si për aktivet dhe detyrimet financiare dhe ato jo financiarë. Vlerat e drejta janë përcaktuar për qëllime të matjes dhe/ose paraqitjes, bazuar në metodat vijuese. Kur është e zbatueshme, informacion i mëtejshëm për supozimet e bëra, në përcaktimin e vlerave të drejta pasqyrohen në shënimet specifike për atë aktiv ose detyrim. Për më tepër, në shënimin 26 përshkruhen gjykimet e përdorura në njohjen e aktiveve dhe detyrimeve tatimore të shtyra.

**(a) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare**

Në vijim të ndryshimit të pronësisë të paraqitur në shënimin 1, Shoqëria ka përdorur çmimin e transaksionit për të përcaktuar vlerën e drejtë të aktiveve. Drejtimi konkludoi se aktivet nuk janë zhvlerësuar duke qenë se çmimi i transaksionit tejkalon vlerën e aktiveve.

Pavarësisht humbjeve të ndodhura gjatë viteve të para të veprimtarisë së Shoqërisë, ajo pret të rezultojë fitimprurëse dhe të gjenerojë flukse monetare pozitive në të ardhmen. Projektimet e flukseve monetare të ardhshme varen nga rishikimi dhe përfundimi i suksesshëm i produkteve të Shoqërisë dhe përshtatja e mëtejshme e tyre ndaj tregut lokal. Shoqëria ka marrë masa për të rritur të ardhurat dhe duke optimizuar kostot operacionale. Ajo është duke analizuar nevojat për të rishikuar planin e marketingut, ndërsa buxheti tashmë është rishikuar sipas dinamikës së tregut Shqiptar. Për më tepër, Shoqëria është në proces analizimi të nevojave për të përshtatur më tej produktet e saj ndaj tregut Shqiptar. Numri i pikave të shitjes pritet të rritet dhe lloje të reja biletash gërvishëse si edhe produkte të reja do të prezantohen tek konsumatorët në të ardhmen e afërt. Produktet e reja që do prezantohen përfshijnë llotaritë elektronike që pritet të rrisin ndjeshëm të ardhurat.

Nje ndryshim ne ligj aprovuar me 22 Dhjetor 2016, i lejonte kazinote elektronike dhe kazinote bingo te cilat ishin licensuar para se te hynte ne fuqi ky ligj te vazhdonin aktivitetin e tyre vetem ne pikat qe ishin nderkohe ekzistuese dhe ta vazhdonin kete aktivitet deri ne 31 Dhjetor 2018. Manaxhimi beson se bazuar ne licensen qe ajo ka Shoqëria do jete shoqëria e vetme qe do operoje ne disa fusha te veprimtarise se lojrave te fatit dhe kjo do jete avantazhi kryesor konkurrues i Shoqërisë ne periudhat e ardhme. Duke filluar nga 1 Janari 2019 Shoqërite e licensuara te kazinove elektronike dhe basteve sportive nukjane lejuar te operojne ne qytete.

*(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

#### **4. Gjykime dhe vlerësime të rëndësishme (vazhdim)**

*(b) Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera*

Vlera e drejtë e llogaritve të arkëtueshme është vlerësuar të jetë e përafërt vlerën e mbartur në datën e raportimit duke pasur parasysh afatin e shkurtër të të arkëtueshmeve. Detaje të mëtejshme për vjetërsinë dhe zhvlerësimin e të arkëtueshmeve janë përshkruar në shënimin 5 (c).

*(c) Aktivet monetare dhe ekuivalentët*

Aktivitet monetare dhe të ngjashme përfshijnë mjetet monetare në arkë dhe llogarite rrjedhëse me bankat vendase. Meqenëse këto teprica janë afatshkurtër, vlera e tyre e drejtë e tregut është konsideruar të jetë e barabartë me vlerën e mbartur.

*(d) Detyrimet financiare të mbajtura me kosto të amortizuar*

Vlera e drejtë e tregut, e cila përcaktohet për qëllime paraqitjeje, është llogaritur bazuar në vlerën aktuale të flukseve monetare të principalit dhe interesave, të skontuara me normën e interesat të tregut në datën e raportimit. Për huamarrjet, norma e interesit e tregut përcaktohet duke iu referuar marrëveshjeve të ngjashme dhe vlera e drejtë e huave është e përafërt me vlerën e mbartur.

*(e) Provizionet*

Shoqëria ka njohur provizione për çështjet gjyqësore, siç është detajuar në shënimin 15. Shoqëria i konsideron këto provizione si të përshtatshme, duke u bazuar në njohuritë e saj për natyrën e secilit provizion dhe rezultatin e pritur të çështjeve gjyqësore.

#### **5. Menaxhimi i rrezikut financiar**

Shoqëria është e ekspozuar nga rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- Rreziku i tregut
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku i kredisë

Ky shënim përfaqëson informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivat e Shoqërisë, politikat dhe procedurat e matjes dhe menaxhimit të rrezikut dhe menaxhimit të kapitalit të Shoqërisë. Shënime të tjera shpjeguese sasiore janë të përfshira përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat Shoqëria përballet, për të vendosur limite dhe kontrole, dhe monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve.

**Lotaria Kombëtare sh.p.k****Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut janë rishikuar rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, nëpërmjet trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin çdo punonjës kupton rolin dhe detyrimet përkatëse.

*(a) Rreziku i tregut*

Rreziku i tregut është rreziku i humbjes si rrjedhojë e ndryshimeve në çmimet e tregut, në kurset e këmbimit të valutës, në normat e interesit dhe në çmimet e kapitalit.

Niveli i rrezikut të tregut ndaj të cilit ekspozohet Shoqëria, në një moment të caktuar kohe ndryshon në varësi të kushteve të tregut, të pritshmërive të çmimeve të ardhshme apo lëvizjeve në normat e tregut, të përbërjes së aktiveve fizike të Shoqërisë dhe marrëveshjeve në të cilat Shoqëria është angazhuar. Drejtimi vendos limite mbi vlerën e rrezikut që mund të jetë i pranueshëm, i cili monitorohet çdo muaj. Gjithsesi, kjo qasje nuk parandalon humbjet përtej këtyre limiteve në rast të lëvizjeve më të mëdha të tregut.

*(i) Rreziku i kursit të këmbimit*

Pjesa më e madhe e transaksioneve të Shoqërisë kryhet në monedhat Lek dhe Euro. Rreziku i kursit të këmbimit krijohet kur transaksione të ardhshme tregtare ose aktive dhe detyrime të njohura janë të shprehura në një monedhë të ndryshme nga monedha funksionale e Shoqërisë. Duke qenë se huatë janë marrë në Euro, dhe aktiviteti kryhet në Lek, ekziston rreziku i mospërputhjes së monedhave të huaja. Meqë monedha raportuese është Leku, drejtimi vlerëson se rreziku i monedhës së huaj mund të përbëjë një problem për Shoqërinë. Drejtimi vendos kufij mbi nivelin e ekspozimit për çdo monedhë dhe në total. Pozicionet monitorohen çdo muaj. Kurset e këmbimit të mëposhtme, janë aplikuar gjatë periudhës:

	Kursi mesatar		Kursi i këmbimit në datën e raportimit	
	2019	2018	2019	2018
Lek / EUR	123.00	127.58	121.77	123.42
Lek / USD	109.85	108.01	108.64	107.82
Lek / CAD	82.83	83.43	83.38	79.22

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

31 Dhjetor 2019	Euro	Lek	Totali
<b>Aktivitet financiar</b>			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	21,506,355	11,377,928	32,884,283
Kërkesa të arkëtueshme	3,260,985	50,411,508	53,672,493
	<b>24,767,340</b>	<b>61,789,436</b>	<b>86,556,776</b>
<b>Detyrimet financiare</b>			
Të pagueshme ndaj furnitorëve	25,689,442	42,631,732	68,321,174
Detyrime të tjera	-	37,342,802	37,342,802
Detyrimet e lojrave	-	61,327,981	61,327,981
Hua	234,409,331	25,725	234,435,056
	<b>260,098,773</b>	<b>141,328,240</b>	<b>401,427,013</b>
<b>Ekspozimi neto</b>	<b>(235,331,433)</b>	<b>(79,538,804)</b>	<b>(314,870,237)</b>

**Lotaria Kombëtare sh.p.k**  
**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

**5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

(a) Rreziku i tregut (vazhdim)

(i) Rreziku i kursit të këmbimit (vazhdim)

<b>31 Dhjetor 2018</b>	<b>Euro</b>	<b>Lek</b>	<b>Totali</b>
<b>Aktivët financiarë</b>			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	22,742,302	5,860,644	28,602,946
Kërkesa të arkëtueshme	11,480,695	40,516,003	51,996,698
	<b>34,222,997</b>	<b>46,376,647</b>	<b>80,599,644</b>
<b>Detyrimet financiarë</b>			
Të pagueshme ndaj furnitorëve	19,110,078	5,672,165	24,782,243
Detyrime të tjera	-	39,655,585	39,655,585
Detyrimet e lojrave	-	57,957,348	57,957,348
Hua	92,664,435	-	92,664,435
	<b>111,774,513</b>	<b>103,285,098</b>	<b>215,059,611</b>
<b>Ekspozimi neto</b>	<b>(77,551,516)</b>	<b>(56,908,451)</b>	<b>(134,459,967)</b>

Duke menaxhuar rrezikun e kursit të këmbimit, Shoqëria synon të reduktojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë. Në afatgjatë, megjithatë, ndryshime të përhershme në kursin e këmbimit të monedhës së huaj mund të kenë një ndikim në fitim. Një vlerësim ose zhvlerësim i Lekut, siç paraqitet më poshtë, mund të ketë ndikimet përkatëse në ulje ose rritje të kapitalit dhe të fitimit ose humbjes me shumat e paraqitura më poshtë. Kjo analizë bazohet në variancat prej 10% të kurseve të këmbimit të monedhave të huaja, që Shoqëria konsideron në mënyrë të arsyeshme të mundshme në fund të periudhës raportuese.

<i>Në Lek</i>	<b>31 Dhjetor 2019</b>		<b>31 Dhjetor 2018</b>	
	Rritje	Rënie	Rritje	Rënie
<b>EUR</b>	(23,533,143)	23,533,143	(7,755,152)	7,755,152

(ii) Rreziku i normës së interesit

Rreziku kyresor ndaj të cilit portofolet jo të tregtueshme janë ekspozuar janë rreziqet nga luhatja e flukseve të ardhshme monetare ose vlerës së drejtë të instrumenteve financiarë për shkak të ndryshimit të normës së interesit të tregut (ndryshimi/hendeku mes vlerës aktuale neto të aktiveve dhe detyrimeve). Rreziku i normës së interesit manaxhohet kryesisht nëpërmjet monitorimit të diferencave të normave të interesit. Menaxhimi i rrezikut të normës së interesit kundrejt kufijve të ndryshimit të normës së interesit plotësohet nga monitorimi i ndjeshmërisë së aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë ndaj skenarëve të ndryshëm standarde dhe jo standarde të normave të interesit. Skenarë standarde që konsiderohen në baza të rregullta përfshijnë 100 pikë baze rënie ose rritje paralele në të gjitha kurbat e normave të kthimit.

Shoqëria ka marre një hua interes-bartëse me shoqërinë mëmë gjate vitit 2018 (shih shënimin 14). Huaja kishte një normë interesi 3.135% p.a dhe afati i shlyerjes është deri më 31 Maj 2021. Gjate vitit 2019 kjo kontrate u amendua duke e shtuar vlerën e huasë dhe duke ndryshuar normën e interesit në 7.331%. Huaja shlyhet më një këst të vetëm në afatin përfundimtar. Më 31 dhjetor 2019, huatë përfshijnë karta krediti biznesi, afatshkurtra të cilat përdoren për nevojat e kapitalit qarkullues me një normë interesi prej 14% p.a për karten në Euro dhe 17% për kartën në Lek.

Një analizë e ndjeshmërisë së Shoqërisë ndaj rritjes apo rënies së normave të interesit në treg (duke supozuar që nuk ka lëvizje asimetrike të kurbave të kthimit në treg dhe një pozitë konstante e pozicionit financiar) jepet si më poshtë:

<i>Në Lek</i>	<b>31 dhjetor 2019</b>		<b>31 dhjetor 2018</b>	
	100 pb rritje	100 pb rënie	100 pb rritje	100 pb rënie
Efkti i vlerësuar i fitim/(humbjes)	(2,344,351)	2,344,351	(926,644)	926,644



**Lotaria Kombëtare sh.p.k****Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)***(a) Rreziku i tregut (vazhdim)**(iii) Menaxhimi i kapitalit*

Bazuar në legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të sigurohet licenca për “Lotari Kombëtare”, kapitali minimal i kërkuar është 1,200,000,000 Lek. Në fund të 31 dhjetorit 2019, kapitali i nënshkruar i Shoqërisë është 2,725,515,000 Lek. (31 dhjetorit 2018: 2,570,940,000 Lek). Pas rritjes së kapitalit në 2017 kapitali neto nuk është më negativ.

*(b) Rreziku i likuiditetit*

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria do të hasë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve kur ato janë të pagueshme. Shoqëria është e ekspozuar çdo ditë ndaj kërkesës për burimet e saj monetare kryesisht për të shlyer shpenzimet operative që kryhen gjatë aktivitetit të zakonshëm të saj.

Qasja e Shoqërisë për të menaxhuar likuiditetin është të sigurohet, sa më shumë të jetë e mundur që do të ketë gjithmonë likuiditetin e nevojshëm për të përmbushur detyrimet e saj në afat, si në kushte normale dhe në ato të rënda, pa pësuar humbje të papranueshme ose rrezikuar dëmtimin e imazhit të Shoqërisë. Shoqëria pret të përmbushë detyrimet përmes flukseve të pritshme të parasë nga aktiviteti dhe me mbështetje nga mëma.

Detyrimet më të rëndësishme deri më 31 dhjetor 2019 perbehen nga huaja nga mëma e disbursuar gjatë vitit 2018 dhe 2019. Rreziku i likuiditetit menaxhohet nëpërmjet kontributeve të mëmës.

Tabela e mëposhtme tregon flukset e aktualizuara të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë duke marrë për bazë maturitetin më të hershëm kontraktual ose flukset e pritshme.

<b>31 Dhjetor 2019</b>	<b>Deri ne 3 muaj</b>	<b>Nga 3 muaj deri ne 1 vit</b>	<b>Me shume se 1 vit</b>	<b>Totali</b>
<b>Detyrimet financiare</b>				
Të pagueshme ndaj furnitorëve	64,383,529	-	-	64,383,529
Detyrime të tjera	37,342,802	-	-	37,342,802
Hua	6,218,197	6,248,805	221,968,054	234,435,056
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>107,944,528</b>	<b>6,248,805</b>	<b>221,968,054</b>	<b>336,161,387</b>

<b>31 Dhjetor 2018</b>	<b>Deri ne 3 muaj</b>	<b>Nga 3 muaj deri ne 1 vit</b>	<b>Me shume se 1 vit</b>	<b>Totali</b>
<b>Detyrimet financiare</b>				
Të pagueshme ndaj furnitorëve	24,782,243	-	-	24,782,243
Detyrime të tjera	23,868,591	-	-	23,868,591
Hua	99,435	-	92,565,000	92,664,435
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>48,750,269</b>	<b>-</b>	<b>92,565,000</b>	<b>141,315,269</b>

**Lotaria Kombëtare sh.p.k****Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)***(b) Rreziku i kredisë*

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Shoqërisë nëse një klient ose një palë e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimin e tij kontraktual që lind kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë dhe nga mjetet monetare të mbajtura ne banka.

Rreziku potencial i kredisë në marrëdhëniet tregtare ekziston kryesisht me pikat e shitjes nën një marrëveshje bashkëpunimi, zbutet nga procedura specifike të përzgjedhjeje të pikave të shitjes, duke vendosur limite operative mbi vlerat e luajtura në терминаlet e lojërave dhe prej kontrolleve ditore mbi ndryshimin e balancave debitorë, çka në rastet e mos pagesave, mund të rezultojë me bllokimin e terminalit ose revokimin e autorizimit për të vepruar si një pikë shitjeje e Lotarisë Kombëtare kur evidentohen raste të vazhdueshme të mos-pagesave.

Ekspozimi maksimal i i Shoqërisë me 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është si me poshte:

<b>Classes of financial assets - carrying amounts:</b>	<b>2019</b>	<b>2018</b>
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	32,884,283	28,602,946
Llogari të arkëtueshme dhe aktive të tjera	51,897,576	39,487,985
<b>Total</b>	<b>84,781,859</b>	<b>68,090,931</b>

Kërkesat e arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 sipas vjetërsisë janë detajuar si më poshtë:

	<b>2019</b>	<b>%</b>	<b>2018</b>	<b>%</b>
Më pak se 1 muaj	37,585,592	75.21%	30,382,633	80.92%
1 deri në 3 muaj	6,139,692	12.29%	2,548,360	6.79%
Mbi 3 muaj	6,248,030	12.5%	4,616,141	12.29%
<b>Totali</b>	<b>49,973,314</b>	<b>100.00%</b>	<b>37,547,134</b>	<b>100.00%</b>

Drejtimi pret të arkëtojë të gjithë të arkëtueshmet gjendje në fund të vitit. Të arkëtueshmet janë kryesisht detyrime nga partnerët kontraktualë.

**Lotaria Kombëtare sh.p.k**  
**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

*(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

**6. Aktive afatgjata materiale**

	<b>Pajisje te lojrave të fatit</b>	<b>Pajisje kompjuterike</b>	<b>Mjete transporti</b>	<b>Përmirësimi i objekteve me qira</b>	<b>Pajisje të tjera</b>	<b>Mobilje zyrash dhe pajisje</b>	<b>Totali</b>
<b>Kosto</b>							
<b>Më 1 janar 2018</b>	<b>279,203,576</b>	<b>55,839,207</b>	<b>41,767,117</b>	<b>1,660,141</b>	<b>5,993,952</b>	<b>11,268,850</b>	<b>395,732,841</b>
Shtesa	981,797	218,114	-	-	224,000	587,575	2,011,486
Nxjerrje nga përdorimi	(3,847,388)	-	-	-	-	(364,000)	(4,211,388)
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>276,337,985</b>	<b>56,057,321</b>	<b>41,767,117</b>	<b>1,660,141</b>	<b>6,217,952</b>	<b>11,492,425</b>	<b>393,532,940</b>
Shtesa	23,522,896	1,649,485	-	-	332,938	781,757	<b>26,287,076</b>
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	-	-	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>299,860,881</b>	<b>57,706,806</b>	<b>41,767,117</b>	<b>1,660,141</b>	<b>6,550,890</b>	<b>12,274,182</b>	<b>419,820,017</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>							
<b>Më 1 janar 2018</b>	<b>(128,406,278)</b>	<b>(44,149,956)</b>	<b>(40,186,972)</b>	<b>(802,586)</b>	<b>(4,252,836)</b>	<b>(8,352,277)</b>	<b>(226,150,905)</b>
Shpenzimi për vitin	(29,388,880)	(4,015,317)	(1,493,664)	(243,902)	(898,012)	(1,461,235)	(37,501,009)
Nxjerrje nga përdorimi	2,021,695	-	-	-	-	293,584	2,315,278
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>(155,773,464)</b>	<b>(48,165,273)</b>	<b>(41,680,636)</b>	<b>(1,046,488)</b>	<b>(5,150,847)</b>	<b>(9,519,927)</b>	<b>(261,336,635)</b>
Shpenzimi për vitin	(29,253,614)	(3,998,898)	(86,481)	(178,572)	(756,506)	(587,724)	<b>(34,861,795)</b>
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	-	-	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>(185,027,077)</b>	<b>(52,164,171)</b>	<b>(41,767,117)</b>	<b>(1,225,060)</b>	<b>(5,907,354)</b>	<b>(10,107,652)</b>	<b>(296,198,431)</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>							
<b>Më 1 janar 2018</b>	<b>150,797,296</b>	<b>11,689,251</b>	<b>1,580,145</b>	<b>857,555</b>	<b>1,741,116</b>	<b>2,916,573</b>	<b>169,581,936</b>
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>120,564,521</b>	<b>7,892,048</b>	<b>86,481</b>	<b>613,653</b>	<b>1,067,105</b>	<b>1,972,497</b>	<b>132,196,304</b>
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>114,833,804</b>	<b>5,542,635</b>	<b>-</b>	<b>435,081</b>	<b>643,536</b>	<b>2,166,530</b>	<b>123,621,586</b>

**Lotaria Kombëtare sh.p.k**

**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

**7. Aktivet me të drejtë përdorimi**

Më poshtë janë paraqitur vlerat kontabël të aktiveve me të drejtë përdorimi të njohura gjatë vitit dhe lëvizjet respektive:

	<b>Aktivët me të drejtë përdorimi – Pasuri të paluajtshme</b>	<b>Totali</b>
<b>Më 1 janar 2018</b>	-	-
Shtesa	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	-	-
Shtesa	24,930,642	24,930,642
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>24,930,642</b>	<b>24,930,642</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>		
<b>Më 1 janar 2018</b>	-	-
Shpenzimi për vitin	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	-	-
Shpenzimi për vitin	(8,099,385)	(8,099,385)
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>(8,099,385)</b>	<b>(8,099,385)</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>		
<b>Më 1 janar 2018</b>	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>16,831,257</b>	<b>16,831,257</b>

**8. Aktive afatgjata jo-materiale**

	<b>Programe TI</b>	<b>Licensa</b>	<b>Aktiv në proces</b>	<b>Totali</b>
<b>Më 1 janar 2018</b>	<b>30,782,688</b>	<b>500,000,000</b>	-	<b>530,782,688</b>
Shtesa	-	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>30,782,688</b>	<b>500,000,000</b>	-	<b>530,782,688</b>
Shtesa	322,367	-	34,223,600	34,545,967
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>31,105,055</b>	<b>500,000,000</b>	<b>34,223,600</b>	<b>565,328,655</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>				
<b>Më 1 janar 2018</b>	<b>(27,050,481)</b>	<b>(233,333,333)</b>	-	<b>(260,383,814)</b>
Shpenzimi për vitin	(689,023)	(50,000,000)	-	(50,689,023)
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>(27,739,504)</b>	<b>(283,333,333)</b>	-	<b>(311,072,837)</b>
Shpenzimi për vitin	(736,035)	(50,000,000)	-	(50,736,035)
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>(28,475,539)</b>	<b>(333,333,333)</b>	-	<b>(361,808,872)</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>				
<b>Më 1 janar 2018</b>	<b>3,732,207</b>	<b>266,666,667</b>	-	<b>270,398,874</b>
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>3,043,184</b>	<b>216,666,667</b>	-	<b>219,709,851</b>
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>2,629,516</b>	<b>166,666,667</b>	<b>34,223,600</b>	<b>203,519,783</b>

**Lotaria Kombëtare sh.p.k**  
**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

**9. Inventarët**

	<u>2019</u>	<u>2018</u>
Biletat gervishtese	29,997,020	27,228,588
Pjese kembimi	6,395,015	6,433,844
Materialet e tjera	3,781,187	1,952,708
Skedat e lotarise	3,636,566	1,744,672
Leter per bileta lotarie	254,236	597,885
Inventari fizik	<u>44,064,024</u>	<u>37,957,697</u>
Zhvleresimi i skedave te lotarise	(2,142,069)	-
<b>Totali</b>	<u><u>41,921,955</u></u>	<u><u>37,957,697</u></u>

Gjendja e inventareve përbëhet kryesisht nga bileta gërvishtëse, pjesë këmbimi për терминаlet, skeda lotarie dhe materiale të tjera ku përfshihen kryesisht materialet e marketingut

**10. Kërkesa të arkëtueshme**

	<u>2019</u>	<u>2018</u>
Kërkesa të arkëtueshme	49,973,314	37,547,134
<b>Totali</b>	<u><u>49,973,314</u></u>	<u><u>37,547,134</u></u>

Kërkesat e arkëtueshme përfaqësojnë një borxh afatshkurtër të pambledhur nga partnerët kontraktualë më 31 dhjetor 2019 për shitjen e produkteve të lotarisë. Bazuar në marrëveshjen kontraktuale, shuma e pashlyer paraqitet neto nga çmimet e paguara dhe komisionet bonus.

**11. Aktive të tjera**

	<u>2019</u>	<u>2018</u>
Garanci për marreveshjet kontraktuale dhe parapagime	3,903,609	9,974,491
Mjete monetare te bllokuara	1,924,262	1,940,851
Shpenzime të shtyra	1,043,348	1,114,263
Paradhënie ndaj punonjësve	949,959	1,319,959
<b>Totali</b>	<u><u>7,821,178</u></u>	<u><u>14,349,564</u></u>

Garancitë për marrëveshjet kontraktuale dhe parapagim përfaqësojnë shuma të paguara palëve të treta parapagim për shërbime dhe garanci për ambjentet e marra me qira nga Shoqëria për përdorim, si të zyrave qendrore dhe ambjenteve të magajnes. Shpenzimet e shtyra përfaqësojnë parapagimet për primet e sigurimit të automjeteve, shpenzimet e parapaguara për mirëmbajtjen e programit kompjuterik dhe shpenzime për shërbimet e internetit.

Mjetet monetare të bllokuara përfaqësojnë kolateralin e vendosur për karta krediti prej 1,924,262 Lek (2018: 1,940,851 Lek).

**12. Mjete monetare dhe ekuivalente me to**

	<u>2019</u>	<u>2018</u>
<i>Mjete monetare në arkë</i>		
Në Lek	2,180,835	1,215,420
Në Euro	854,752	118,810
	<u>3,035,587</u>	<u>1,334,230</u>
<i>Llogari rrjedhëse</i>		
Në Lek	9,197,093	4,645,224
Në Euro	20,651,603	22,623,492
	<u>29,848,696</u>	<u>27,268,716</u>
<b>Totali</b>	<u><u>32,884,283</u></u>	<u><u>28,602,946</u></u>

**Lotaria Kombëtare sh.p.k****Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***13. Kapitali aksionar**

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2019 është 2,725,515,000 Lek (31 dhjetor 2018: 2,570,940,000 Lek), dhe përbëhet nga 257,094 aksione të zakonshme (2018: 257,094) me vlerë nominale 10,601 Lek (2018: 10,000) për çdo aksion. Struktura aksionare me 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është si vijon:

	2019		2018	
	Totali ne Lek	Në %	Totali ne Lek	Në %
Albanisch Osterreichische Lotterien Holding Gesellschaft	2,725,515,000	100	2,570,940,000	100

**14. Huatë**

	2019	2018
<i>Pjesa afatshkurtër e huave</i>		
Detyrimet për qiratë	2,041,671	-
Pjesa afatshkurtër e huave afatgjata	3,937,645	-
Hua afatshkurtra	238,881	99,435
	<b>6,218,197</b>	<b>99,435</b>
<i>Huate afatgjata</i>		
Detyrimet për qiratë	15,119,359	-
Huate afatgjata	213,097,500	92,565,000
	<b>228,216,859</b>	<b>92,565,000</b>
<b>Total</b>	<b>234,435,056</b>	<b>92,664,435</b>

Në Korrik 2018, Shoqëria u financua nga shoqëria mëmë për një shumë totale prej 1 milionë Euro, me opsionin e disbursimeve sipas nevojës dhe me maturim më 31 Maj 2021. Huaja kishte një normë interesi prej 3.135% p.a. Në Shtator të vitit 2019 shuma e huasë u shtua për vlerën 750 mijë Euro duke e çuar vlerën totale të huasë në 1.75 milionë Euro. Interesi i huasë u ndryshua në 7.33%.

**15. Të pagueshme ndaj furnitorëve**

	2019	2018
Furnitorët vendas	43,024,043	22,512,808
Palë të lidhura	19,854,627	835,560
Furnitorët e huaj	1,504,859	1,433,875
<b>Totali</b>	<b>64,383,529</b>	<b>24,782,243</b>

**16. Detyrime të tjera**

	2019	2018
Taksa të pagueshme	35,275,019	21,850,643
Provizione të tjera	15,836,962	13,185,510
Shpenzime të përlllogaritura	2,905,639	2,486,182
Detyrime të tjera	2,350,031	889,648
Detyrime për sigurimet shoqërore	1,160,520	1,075,089
Detyrime ndaj personelit	320,680	53,211
Të ardhura të shtyra	254,300	115,300
<b>Totali</b>	<b>58,103,151</b>	<b>39,655,583</b>

Shpenzimet e përlllogaritura përfshijnë komunikim telefonik, shpenzime utilitare dhe shpenzimet e tjera të përlllogaritura të ndodhura gjatë vitit, për të cilat faturat janë marrë pas datës së raportimit.

**Lotaria Kombëtare sh.p.k**  
**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

**16. Detyrime te tjera (vazhdim)**

Tatimet e pagueshme ndahen si më poshtë:

	<b>2019</b>	<b>2018</b>
Detyrime tatimore të lojrave të fatit	19,186,056	10,295,549
Taksa lokale	6,077,858	5,647,358
Tatim mbi të ardhurat personale	3,146,574	2,679,048
Tatim në burim	5,525,233	2,464,330
Provizione për penalitete tatimore	-	500,000
TVSH e pagueshme	1,339,298	264,358
<b>Totali</b>	<b>35,275,019</b>	<b>21,850,643</b>

Detyrimet tatimore nga lojrat e fatit kanë lindur nga aktiviteti deri më 31 Dhjetor 2019.

Lëvizjet ne provizionet per ceshtjet gjyqesore perfshire ato me ish punonjes janë si më poshtë:

	<b>2019</b>	<b>2018</b>
Gjendja më 1 janar	13,185,510	11,643,760
Provizione të regjistruara gjatë vitit (shënimi 25)	2,651,452	1,541,750
Provizione të përdorura gjatë vitit	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor</b>	<b>15,836,962</b>	<b>13,185,510</b>

**17. Detyrimet e lojrave**

	<b>2019</b>	<b>2018</b>
Detyrimet e lojrave bileta gervishtëse	28,602,172	29,122,772
Detyrimet e lojrave Lotto 6/39	28,724,960	28,839,208
Detyrimet e lojrave Keno	(332,993)	(4,632)
Detyrimet e lojrave Porta e fatit	4,333,842	-
<b>Total</b>	<b>61,327,981</b>	<b>57,957,348</b>

**18. Të ardhura nga lotaritë**

	<b>2019</b>	<b>2018</b>
Të ardhura – Biletat gervishtëse	552,832,000	260,760,000
Të ardhura – Porta e fatit	43,198,600	-
Të ardhura – Loto 6 nga 39	32,630,100	32,757,900
Të ardhura – Keno	22,955,070	11,126,042
<b>Totali</b>	<b>651,615,770</b>	<b>304,643,942</b>

**19. Shpenzime marketingu**

	<b>2019</b>	<b>2018</b>
Shpenzime për mediat	58,005,866	34,649,830
Shpenzime për reklama dhe promocione	9,753,688	10,820,332
Tarifa për agjencite	4,051,858	3,600,000
Sponsorizime	1,204,060	2,467,540
<b>Totali</b>	<b>73,015,472</b>	<b>51,537,702</b>

**Lotaria Kombëtare sh.p.k**  
**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

**20. Shpenzime për çmimet e lotarisë**

	<u>2019</u>	<u>2018</u>
Fondi i çmimeve për biletat gërvishtëse	327,980,764	142,580,466
Fondi i çmimeve për portën e fatit	62,063,919	-
Fondi i çmimeve për Keno	17,027,530	8,390,675
Fondi i çmimeve për loton 6 nga 39	9,768,211	9,911,635
<b>Totali</b>	<b><u>416,840,424</u></b>	<b><u>160,882,776</u></b>

**21. Shpenzimet e personelit**

Shpenzimet e personelit përbëhen nga sa më poshtë:

	<u>2019</u>	<u>2018</u>
Shpenzime page	101,707,665	97,856,766
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	7,960,615	7,946,057
Bonuse dhe shpërblime të tjera	21,000	21,000
<b>Totali</b>	<b><u>109,689,280</u></b>	<b><u>105,823,823</u></b>

Shoqëria kishte 48 punonjës më 31 Dhjetor 2019 (2018: 49), duke përfshirë 2 punonjës të huaj.

**22. Taksat dhe tarifat e lojrave**

	<u>2019</u>	<u>2018</u>
Tatimi për lojrat e fatit	35,206,211	28,208,507
Tarifë kontributi për çështjet e mira	14,338,605	6,704,210
Tarifa administrimi ndaj 'Autoritetit mbikqyrës i lojrave të fatit'	3,258,774	2,000,000
<b>Totali</b>	<b><u>52,803,590</u></b>	<b><u>36,912,717</u></b>

**23. Komisione ndaj agentëve**

Lotaria Kombëtare operon me shumë partnerë kontraktualë, të cilët tregtojnë produktet e Shoqërisë në gjithë territorin e Shqipërisë. Partnerët kontraktualë janë entitete të pavarura nga Shoqëria, si subjekte të regjistruara ose persona fizike ose biznese më të mëdha dhe përfitojnë nga komisionet e shitjeve në varësi të volumit të shitjeve. Për vitin 2019 dhe 2018 komisionet ndaj agentëve janë si më poshtë:

	<u>2019</u>	<u>2018</u>
Komisione ndaj agentëve – Bileta gërvishtëse	45,806,502	21,228,762
Komisione ndaj agentëve – Porta e fatit	4,063,103	-
Komisione ndaj agentëve – Lotto	3,642,726	3,738,556
Komisione ndaj agentëve - Keno	2,429,401	1,171,514
<b>Totali</b>	<b><u>55,941,732</u></b>	<b><u>26,138,832</u></b>

**24. Kosto e materialeve të përdorura**

	<u>2019</u>	<u>2018</u>
Kosto e biletave gërvishtëse	39,731,537	21,156,877
Kosto e biletave "Porta e fatit"	843,332	-
Kosto letrës së biletave të lotarisë	343,649	362,009
Kosto e skedave të lotarisë	250,176	319,986
<b>Totali</b>	<b><u>41,168,694</u></b>	<b><u>21,838,872</u></b>



**Lotaria Kombëtare sh.p.k****Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***25. Shpenzimet e tjera operative**

Shpenzimet e tjera operative përbëhen nga sa më poshtë:

	<b>2019</b>	<b>2018</b>
Taksa te tjera nga tatim fitimi	41,269,746	17,068,855
Tarife terminimi	24,676,000	-
Shpenzime IT	17,604,376	21,541,843
Nxjerrja jashte perdorimit e inventarit	16,154,210	19,351,004
Shpenzime telekomunikimi dhe postare	11,471,750	7,061,367
Shpenzime qiraje	7,627,218	14,963,193
Mirembajtje dhe riparime	6,200,457	4,337,660
Te tjera shpenzime	6,065,264	4,945,089
Shpenzime keshillimi	4,215,498	4,544,703
Shpenzime karburanti	3,562,551	3,647,532
Provizione për raste gjyqësore (shënimi 16)	2,651,452	1,541,750
Shpenzime udhëtimi	2,276,902	2,913,187
Shpenzime perfaqesimi	2,203,967	2,132,392
Materiale dhe furnizime	2,043,993	7,032,678
Zhvlerësimi i inventarit (shënimi 9)	2,142,069	-
Sigurime	1,593,786	1,628,906
Shpenzime komunale	1,368,827	1,305,927
Tarifa per ofrimin e sherbimit Keno	633,923	297,151
Gjoha për tatime	191,330	786,918
Shpenzime sigurie	183,600	201,600
Trajnime	132,699	177,597
Humbja nga nxjerrja nga përdorimi i pajisjeve	-	1,564,137
Shpenzime rekrutimi	-	124,666
<b>Totali</b>	<b>154,269,618</b>	<b>117,168,155</b>

Shpenzime te tjera përmbledh të gjitha shpenzimet e tjera si kancelari, marteriale pastrimi për zyrat, shërbime nga të tretë, shpenzime administrative si dhe shpenzime transporti për personelin.

**26. Të ardhura dhe shpenzime financiare, neto**

	<b>2019</b>	<b>2018</b>
<i>Të ardhura financiare</i>		
Të ardhurat nga interesi mbi depozitat bankare	1	16,808
Fitimi neto nga diferencat e konvertimit	1,308,959	-
Të ardhura të tjera financiare	-	120
<b>Total i të ardhurave financiare</b>	<b>1,308,960</b>	<b>16,928</b>
<i>Shpenzimet financiare</i>		
Humbja neto nga diferencat e konvertimit	-	(2,516,798)
Shpenzimet e interesit te qirave	(823,320)	
Shpenzimet e interesit te huave	(7,900,210)	(1,135,510)
Shpenzime të tjera financiare	(469,105)	(518,711)
<b>Total i shpenzimeve financiare</b>	<b>(9,192,635)</b>	<b>(4,171,019)</b>
<b>Shpenzime neto financiare</b>	<b>(7,883,675)</b>	<b>(4,154,091)</b>

**Lotaria Kombëtare sh.p.k**  
**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

**27. Tatimi mbi fitimin**

Në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar, norma e aplikueshme e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatimi i njohur në fitim ose humbje përbëhet nga sa më poshtë:

	<b>2019</b>	<b>2018</b>
Shpenzimi i tatim-fitimit	-	-
Shpenzimi tatimor i shtyrë	2,463,290	1,102,783
<b>Totali</b>	<b>2,463,290</b>	<b>1,102,783</b>

	<b>%</b>	<b>2019</b>	<b>%</b>	<b>2018</b>
Rakordimi i tatim fitimit efektiv				
Humbja për vitin		(351,555,247)		(306,774,905)
Tatim fitimi me normën e aplikueshme	15	(52,733,287)	15	(46,016,236)
Shpenzimet e panjohura	(3)	11,432,592	(2)	5,876,773
Humbjet e panjohura tatimore	(13)	44,413,509	(14)	42,766,738
Diferenca të përkohshme të panjohura	0.18	(649,529)	(0.5)	(1,524,492)
<b>Totali</b>		<b>(0.70)</b>	<b>(0.36)</b>	<b>1,102,783</b>

Humbjet fiskale të vitit 2016 nuk janë mbartur pasi humbjet fiskale nuk mund të mbarten pas ndryshimeve në strukturën e pronësisë për më shumë se 50% (shiko shënimin 1).

Shoqëria nuk ka njohur aktive tatimore të shtyra në lidhje me humbjet e akumuluarat tatimore prej 42,766,738 Lek, edhe pse është e mundur që Shoqëria të rezultojë me fitim në të ardhmen. Drejtimi pret që Shoqëria të gjenerojë fitime në të ardhmen dhe duke filluar nga periudha kur do të raportohen fitimet, ajo mund të fillojë të njohë aktivet tatimore të shtyra në atë masë që realizimi i përfitimit tatimor të lidhur është i mundshëm.

Tatim fitimi i shtyrë llogaritet bazuar në normën e miratuar tatimore 15% (2018: 15%). Aktivi dhe detyrimi i tatimor i shtyrë i njohur u atribuohet zërave të mëposhtëm:

<b>Të njohur</b>	<b>Aktivi</b>		<b>Detyrimi</b>		<b>Neto</b>	
	<b>2019</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>	<b>2018</b>
Aktive afatgjata materiale	682,683	-	-	1,021,230	682,683	(1,021,230)
Shpenzime të nisjes	1,794,189	2,346,247	-	-	1,794,189	2,346,247
Aktive afatgjata jomateriale	-	-	17,713,261	14,048,650	(17,713,261)	(14,048,650)
Aktive me të drejtë përdorimi	-	-	3,739,596	-	(3,739,596)	-
Detyrime për qeratë	3,789,062	-	-	-	3,789,062	-
	<b>6,265,933</b>	<b>2,346,247</b>	<b>21,452,857</b>	<b>15,069,880</b>	<b>(15,186,923)</b>	<b>(12,723,634)</b>

**Lotaria Kombëtare sh.p.k****Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***28. Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara***Ligjore*

Në rrjedhën normale të biznesit, Shoqëria ka qenë e përfshirë në disa pretendime ligjore dhe gjyqësore me konkurentë, punonjës dhe administratën shtetërore për të cilat provizionet e lidhura me to janë njohur sipas nevojës.

*Angazhimet për qira*

Shoqëria nuk ka asnjë marrëveshje qiraje të paanulueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018. Shoqëria ka nënshkruar një marrëveshje qiraje për ambientet e zyrave të veta dhe për apartamente të cilat janë të anulueshme me njoftim paraprak sipas kushteve kontraktuale. Kontratat e qirasë janë të anulueshme, me një periudhë maksimale njoftimi prej 90 ditësh. Angazhimet maksimale të paanulueshme të qirasë më 31 dhjetor 2019 janë 1,921 mijë Lek (2018: 3,962 mijë Lek).

*Garanci te vëna për Shoqërinë*

Një garanci në shumën e 20,000,000 Lek është dhënë ndaj Ministrisë së Financave, Qeveria Shqiptare, siç kërkohet nga kushtet e marrëveshjes së licencës, e cila është siguruar nga Novomatic Gaming Industries GmbH (shiko shënimin 1).

**29. Palët e lidhura**

Një përmbledhje e balancave me palët e lidhura është si më poshtë:

	<u>2019</u>	<u>2018</u>
<i>Të ardhura</i>		
Shërbime midis filialeve	-	271,973
<i>Shpenzime me filiale</i>		
Shërbime konsulence	24,678,000	-
Qira	1,032,969	1,070,559
Komisione	1,644,188	901,504
Interesa dhe garanci	7,773,405	1,118,600
<i>Blerje asetesh</i>		
Nga Kompania Mëmë	23,522,896	-
<i>Të arketueshme</i>		
Nga filialet	445,828	265,353
<i>Të pagueshme</i>		
Ndaj filialeve	513,488	229,406
Ndaj shoqërisë Mëmë		
Llogari te pagueshme	19,341,138	-
Kredi	213,097,500	92,565,000
Interesa kredie dhe komisione garancie	3,937,645	606,158

Totali i kompensimit të paguar për drejtuesit kryesorë të Shoqërisë gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2019 është 40,703,096 Lek (2018: 41,196,297 Lek).

Garancitë e vëna nga palët e lidhura janë detajuar në shënimin 28.

### **30. Ngjarjet pas datës së raportimit**

Në fund të vitit 2019 dolën për herë të parë lajmet nga Kina në lidhje me COVID-19 (Coronavirus).

Stuata në fund të vitit ishte që një numër i kufizuar rastesh nga virusi i panjohur ishin raportuar në Organizaten Botërore të Shëndetësisë. Në muajt e parë të vitit 2020 virusi ishte shpërndarë globalisht dhe ndikimi negativ ishte i dukshëm. Manaxhimi konsideron që kjo ngjarje të jetë një ngjarje joaxhustuese pas datës së bilancit. Shoqëria ka mbyllur aktivitetin e shitjes së produkteve të saj për një periudhë të përkohshme dhe e ka rihapur atë në datë 18 Maj 2020. Ndërsa kjo është ende një situatë në zhvillim gjatë kohës së përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare, manaxhimi beson se nuk do të ketë ndikim thelbesor në vazhdimësinë e operimit të Shoqërisë. Menaxhimi do vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do ndër marrë gjithë hapat e mundshëm për të zbutur cfarëdo efekesh.

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit për të cilat kërkohet rregullim apo shënim në këto pasqyra financiare.